



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



RAPORTI I PËRMBUSHJES SË CAQEVE PËR GJASHTËMUJORIN E PARË TË VITIT 2018

Analizë krahasuese e të dhënave të aprovuara
me ato të realizuara për gjashtëmujin e parë të
vitit 2018 nga procesi tarifor 2018-2020

Punuar nga DT/ ARRU
Shtator 2018
Prishtinë



Vizioni

“Shërbime cilësore, të sigurt dhe efçente të shërbimeve të ujit, për të gjithë konsumatorët në Kosovë”

Misioni

“Rregullimi i shërbimeve të ujit në mënyrë efektive dhe transparente në pajtim me praktikën e mira Evropiane të cilat sigurojnë që ofruesit e shërbimeve të ujit të japin shërbime kualitative, të qëndrueshme dhe me çmime të përballueshme në tërë Kosovën, duke pasur parasysh ruajtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit Publik”

PËRMBAJTA

1	Parathënie	5
2	Qëllimi i raportit	6
KAPITULLI 1		7
1	Komponentet e vlerësimit të caqeve	8
1.1	Lista e të dhënave që monitorohen për përmbushjen e caqeve	8
1.2	Shkallëzimi i përmbushjes së caqeve	9
1.3	Simboli dhe ngjyra e realizimit të cakut	9
2.	Analiza e prodhimit, faturimit dhe konsumatorëve.....	10
2.1	Paraqitja grafike e ujit të prodhuar, të humbur, të faturuar në m ³ dhe numrit të konsumatorëve.....	11
3.	Analiza e shpenzimeve operative.....	13
3.1	Shpenzimet operative për ujë dhe ujëra të ndotura.....	14
3.2	Paraqitja grafike e shpenzimeve operative për ujë dhe ujëra të ndotura	15
4.	Analiza e faturimit dhe arkëtimit në vlerë financiare	17
4.1.	Shuma e faturimit për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura.....	18
4.2	Paraqitja grafike e faturimit për ujë dhe ujëra të ndotura.....	19
4.3.	Shuma e arkëtimit për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura	21
4.4.	Paraqitja grafike e arkëtimit për ujë dhe ujëra të ndotura	22
5.	Analiza e investimeve kapitale.....	24
5.1.	Shumat e investimeve kapitale nga burimet e vetëfinancimit.....	25
5.2.	Paraqitja grafike e të dhënave për investime kapitale nga burimet e vetëfinancimit të kompanive	28
5.3.	Shumat e investimeve kapitale të financuara nga donatorët	29
5.4.	Paraqitja grafike e të dhënave për investimet kapitale nga donatorët	32
KAPITULLI 2		33
1.	Analiza e humbjeve të ujit.....	34
2.	Sasia e ujit e cila kthehet në para	35
3.	Shpenzimet e pagave	36
4.	Shpenzimet e energjisë elektrike	38
KAPITULLI 3		39
1.	Konkluzione dhe Rekomandime	40

Akronimet dhe shkurtesat

ARRU	Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BPRR	Biznes Plane Rregullatore
BARRA	Baza Rregullatore e Aseteve
DRP	Departamenti për raportim të performancës në ARRU
DT	Departamenti i Tarifave në ARRU
FE	Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Bifurkacioni” sh. a – Ferizaj
FPU	Fabrika e Përpunimit të Ujit
GJA	Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Radoniqi” sh. a – Gjakovë
GJI	Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Hidromorava” sh. a – Gjilan
GSJP	Grupi për Studime Juridike dhe Politike
IÇKK	Indeksi i Çmimit të Konsumit në Kosovë
KRU	Kompania Rajonale e Ujësjellësit
MIT	Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Mitrovica” sh. a – Mitrovicë
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
NjPMNP	Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
PE	Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Hidrodrini” sh. a – Pejë
PR	Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Prishtina” sh. a – Prishtinë
PZ	Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Hidroregjioni-Jugor” sh. a – Prizren
U.N	Ujëra të ndotura

1 PARATHËNIE

Sipas praktikave të mira, të përvetësuara nga ARRU edhe kësaj radhe, kemi kënaqësinë të prezantojmë Raportin e gjashtëmujorit të vitit 2018 mbi Vlerësimin e Shkallës së Përbushjes së Caqeve, të procesit rregullator të tarifave afatmesme 2018-2020.

Ky raport pasqyron të dhënat e performancës së veçantë të shtatë (7) (KRU-ve) kompanive regjionale të shërbimeve të ujit dhe ujërave të ndotura, me të cilën vlerësohet shkalla e përbushjes së caqeve të përcaktuara me procesin rregullator të tarifave për gjashtëmujorin e parë të vitit 2018, duke ofruar një pasqyrë të përgjithshme të sektorit për periudhën e shikuar.

Raporti është punuar mbi bazën e tre të dhënave:

- I. Të dhënat e aprovuara nga ARRU gjatë procesit tarifar 2015-2017, për gjashtëmujorin e vitit 2018
- II. Të dhënat e realizuara nga KRU-të për periudhën e njëjtë kohore të gjashtëmujorit të parë të vitit 2018 (të pa audituara), si dhe
- III. Të dhënat historike për gjashtëmujorin parë të vitit 2017, për të vlerësuar trendin e zhvillimit të sektorit.

Raporti si i tillë ndahet në tre kapituj. Kapitulli i parë flet për analizën e përbushjes së caqeve, ku përshkruhet metodologjia e vlerësimit si dhe bëhet analiza për secilën KRU se sa kanë arritur të përbushin cakun e targetuar. Ky vlerësim bëhet duke futur në raport të dhënat e realizuara me ato të aprovuara . Veç tjerash, në secilën tabelë, në kolonën e fundit, është vlerësimi i ARRU-së i cili është i dizajnuar që të shprehet me ngjyrë dhe me simbol, për të pasur më të lehtë të kuptuarit mbi realizimin e caktit. Po ashtu si përmbyllje e raportit, paraqiten edhe konkluzionet dhe përfundimet.

Në kapitullin e tretë është bërë analiza krahasuese në mes të KRU-ve për të vlerësuar, për shembull, se si menaxhojnë me humbjet e ujit, pagat, sasinë e ujit që kthehet në para, shpenzimet e energjisë elektrike, etj. Po ashtu si përmbyllje e raportit, paraqiten edhe konkluzionet dhe përfundimet.

Raporti mbështetet në të dhënat e dërguara nga kompanitë rajonale dhe se këto të dhëna nuk janë të audituara, për dallim nga raporti vjetor.

2 QËLLIMI I RAPORTIT

Procesi tarifor që udhëheq ARRU paraqet një tërësi komplekse të informatave të ndryshme të KRU-ve, përmes të cilave jo vetëm që caktohen tarifatat për shërbimet e ujit dhe të ujërave të ndotura, por aty determinohen edhe një mori të dhënash operative, financiare dhe të investimeve kapitale që i arsyetojnë ato tarifa.

Prandaj, monitorimi i këtyre të dhënave të aprovuara nga ARRU janë të një rëndësie të veçantë për të përcjellur afarizmin e KRU-ve për periudhën e shikuar kohore.

KRU-të deri më tani nuk janë treguar shumë të vëmendshme për të përcjellur deri në fund përmbylljen e procesit tarifor. Ka pasur raste, me disa prej KRU-ve, që pasi është përfunduar procesi tarifor, nuk kanë qenë të sigurta për të dhënat operative dhe financiare që janë aprovuar nga ARRU. Në raste të tjera, KRU-të kanë përdorur të dhëna tjera në planet e tyre të biznesit, dhe jo ato të cilat i ka aprovuar ARRU, e që me ligjin e ri të ARRU-së, të gjitha KRU-të në Kosovë duhet të dorëzojnë për aprovim tek ARRU Biznes Planet e tyre.

Nga të sipër theksuarat, qëllimi i këtij raporti është :

- (i) T'iu rikujtoj KRU-ve, parasëgjithash, se vlerësimi i përmbushjes së caqeve bëhet vetëm me të dhënat e aprovuara gjatë procesit tarifor, dhe se në momentin kur ato aprovohen ato mbesin si të tilla, përveç të ndonjë rishqyrtimi të jashtëzakonshëm të tarifave.
- (ii) Të jepet informacion për shkallën e arritjes së caqeve operative dhe financiare të KRU-ve dhe në veçanti për shkallën e investimeve kapitale të realizuara për periudhën e shikuar kohore të gjashtëmujorit të vitit 2018.
- (iii) Së këndejmi, rezultatet e këtij raporti, janë udhërrëfyes për ARRU dhe KRU se planifikimi duhet të bëhet në mënyrë profesionale, duke respektuar me përpikëri rregullativën ligjore në fuçi.
- (iv) Raporti mbështetet edhe në Parimet e kontabilitetit rregullator dhe metodat në këto udhëzime të kontabilitetit rregullator:
- (v) Llogaritë rregullatore - të dhënat historike që i raportohen rregullatorit për t'i lejuar rregullatorit monitorimin e rezultateve të arritura kundrejt projekteve të përdorura në kohën e caktimit të kontrollimit të çmimeve dhe të vlerësimit të nivelin e performancës së kompanisë në secilin prej aktiviteteve kyçe; dhe
- (vi) Projektionet - në veçanti paraqitja e biznes planit rregullator tek rregullatori, për qëllime të vlerësimit të kërkesave për shpenzimet në të ardhmen dhe përcaktimi i tarifave të duhura.

KAPITULLI 1

ANALIZA E PËRMBUSHJES SË CAQEVE

1 KOMPONENTET E VLERËSIMIT TË CAQEVE

1.1 Lista e të dhënave që monitorohen për përmbushjen e caqeve

Gjatë procesit të përcaktimit të tarifave, ARRU aprovon një mori të dhënash, të cilat e përcaktojnë afarizmin e KRU-së përgjatë tre viteve të procesit tarifar. Në pamundësi për t'i vlerësuar përmbushjen e realizimit për të gjitha këto të dhëna, ARRU përmes këtij raporti merr për bazë vetëm 15 prej tyre, të cilat konsiderohen si të dhëna që mund të japin një pasqyrim të përgjithshëm dhe më objektiv të afarizmit të KRU-së.

Nr	Lista e të dhënave	Njësia	
1	Të dhënat teknike	Prodhimi i Ujit	m ³
2		Humbjet e Ujit	m ³
3		Faturimi i ujit (m3)	m ³
4		Nr i konsumatoreve	Nr
5	Të dhënat financiare	Shpenzimet operative për ujë	€
6		Shpenzimet operative U.N	€
7		Faturimi për ujë (€)	€
8		Faturimi për U.N (€)	€
9		Arkëtimi për ujë (€)	€
10		Arkëtimi për U.N (€)	€
11	Të dhënat e investimeve kapitale vetanake	Investimet vetanake në resurse dhe trajtim të ujit	€
12		Investimet vetanake në distribuimi të ujit	€
13		Investimet vetanake në aktivitetete biznesore për ujë	€
14		Investimet vetanake në grumbullimin e ujërave të ndotura	€
15		Investimet vetanake në aktivitete biznesore për ujera të ndotura	€

Me anë të këtij raporti, ARRU ofron të dhëna në vlera reale për secilën KRU, se cilat shuma janë aprovuar për vitin e caktuar dhe pastaj paraqesim dhe të dhënën se sa ka arritur KRU-ja të realizojë për të njëjtin vit.

1.2 Shkallëzimi i përmbushjes së caqeve

ARRU e ka parasysh se KRU-të mund ta kenë të vështirë që t'i përmbushin caqet në përpikëri, dhe si pasojë e kësaj, kemi shkallëzuar përmbushjen e cakut. Ky shkallëzim përbëhet prej katër kufijve, që bazohet në cakun e paraqitur si përqindje, me detaje të përcaktuara si më poshtë:

- Tejkallim Pozitiv (> 102.00 %)
- Realizuar (98.01% - 102.00%)
- Përafruar (94.00% - 98.00 %)
- Jorealizuar (<94.00 %)

Ndërkaq, për disa të dhëna, vlerësimi pozitiv i përmbushjes së cakut, në aspektin matematikor të fjalës, është më i mirë nëse përqindja e realizimit të tyre është më e vogël se 100%. Kjo ka të bëjë kryesisht me të dhënat e ujit të **humbur në m3, shpenzimeve operative për ujë dhe shpenzimeve operative për ujëra të ndotura**. Për këtë edhe metodologjia e vlerësimit të cakut është pasqyrim i kundërt me kufijtë e paraqitur më lartë, dhe ky pasqyrim matematikisht shprehet si më poshtë:

- Tejkallim Pozitiv (<98 %)
- Realizuar (98.00% - 102.00%)
- Përafruar (102.01 % – 106.00%)
- Jorealizuar (>106.00 %)

1.3 Simboli dhe ngjyra e realizimit të cakut

Duke pasur parasysh se tabelat përmbajnë shumë të dhëna, dhe se lexuesi mund ta ketë të vështirë të orientohet shpejtë, shkallën e përmbushjes së cakut ne e kemi bërë përmes ngjyrave dhe simbolit përkatës. Këto simbole dhe ngjyra, janë detajuar sipas përshkrimeve në tabelat vijuese.

Simboli dhe ngjyra përkatëse për të dhënat e humbjeve të ujit në m³, dhe të shpenzimeve operative.

Kufijtë	Përshkrimi	Simboli
< 98.00 %	Tejkallim Pozitiv	TP
98.00% - 102.00%	Realizuar	R
102.01%- 106.00%	Përafruar	P
> 106.00%	Jorealizuar	JR
	Pakrahasueshëm	PK

Simboli dhe ngjyra përkatëse për të dhënat tjera.

Kufijtë	Përshkrimi	Simboli
> 102.00 %	Tejkallim Pozitiv	TP
98.01% – 102.00%	Realizuar	R
94.00% – 98.00%	Përafruar	P
<94.00%	Jorealizuar	JR
	Pakrahasuar	PK

2. ANALIZA E PRODHIMIT, FATURIMIT DHE KONSUMATORËVE

Analiza në vazhdim ofron të dhëna për këto kategori operative: uji të prodhuar, të humbur dhe të faturuar, të shërbimeve prej nga është bërë krahasimi i të dhënave të realizuara me ato historike si dhe të dhënave të realizuara me të dhënat e aprovuara.


Tabela Nr. 1. Krahasimi i të dhënave të aprovuara të gjashtëmujorit të vitit 2018 me të dhënat e realizuara të gjashtëmujorit të vitit 2018 dhe të dhënat historike për periudhën e njëjtë të vitit 2017.

Emri i KRU	Të dhënat operative	Njësia	Historike 6m 2017	Aprovuara 6m 2018	Realizuara nga KRU-të 6m 2018	% krahasuese 6m 2017 / 6m 2018	% real cak	Vlerësimi për 6m 2018
PR	Uji i prodhuar	m ³	24,613,050	24,313,906	26,226,051	106.55	107.86	TP
	Uji i humbur	m ³	13,911,160	12,400,000	15,396,494	110.68	124.17	JR
	Uji i faturuar	m ³	10,701,890	11,913,906	10,829,557	101.19	90.90	JR
	Konsumatorët	Nr	124,420	133,426	129,594	104.16	97.13	P
PZ	Uji i prodhuar	m ³	8,391,779	8,881,698	8,177,949	97.45	92.08	JR
	Uji i humbur	m ³	4,906,552	4,750,000	4,671,927	95.22	98.36	R
	Uji i faturuar	m ³	3,485,227	4,131,698	3,506,022	100.60	84.86	JR
	Konsumatorët	Nr	44,271	48,252	46,781	105.67	96.95	P
PE	Uji i prodhuar	m ³	12,810,332	11,307,505	12,684,767	99.02	112.18	TP
	Uji i humbur	m ³	8,404,017	6,500,000	8,088,040	96.24	124.43	JR
	Uji i faturuar	m ³	4,406,315	4,807,505	4,596,727	104.32	95.62	P
	Konsumatorët	Nr	43,105	46,169	46,014	106.75	99.66	R
MIT	Uji i prodhuar	m ³	13,820,436	10,024,137	13,861,596	100.30	138.28	TP
	Uji i humbur	m ³	8,302,231	5,011,500	8,563,126	103.14	170.87	JR
	Uji i faturuar	m ³	5,518,205	5,012,637	5,298,470	96.02	105.70	TP
	Faturimi-Jug	m ³	3,040,143	2,790,976	2,887,258	94.97	103.45	TP
	Faturimi-Veri	m ³	2,478,062	2,221,661	2,411,212	97.30	108.53	TP
	Konsumatorët	Nr	28,277	29,221	30,360	107.37	103.90	TP
GJA	Uji i prodhuar	m ³	7,699,039	7,497,451	6,909,501	89.74	92.16	JR
	Uji i humbur	m ³	3,694,477	3,300,000	3,051,863	82.61	92.48	TP
	Uji i faturuar	m ³	4,004,562	4,197,451	3,857,638	96.33	91.90	JR
	Konsumatorët	Nr	34,680	36,332	36,163	104.27	99.53	R
FE	Uji i prodhuar	m ³	3,667,118	3,511,320	3,898,532	106.31	111.03	TP
	Uji i humbur	m ³	2,037,959	1,550,000	2,215,311	108.70	142.92	JR
	Uji i faturuar	m ³	1,629,160	1,961,320	1,683,221	103.32	85.82	JR
	Konsumatorët	Nr	25,594	28,796	26,917	105.17	93.47	JR
GJI	Uji i prodhuar	m ³	4,292,462	4,182,610	4,153,670	96.77	99.31	R
	Uji i humbur	m ³	2,441,017	1,900,043	2,190,462	89.74	115.28	JR
	Uji i faturuar	m ³	1,851,445	2,282,568	1,963,208	106.04	86.01	JR
	Konsumatorët	Nr	25,797	31,824	26,964	104.52	84.73	JR
SEKTORI	Uji i prodhuar	m ³	75,294,216	69,718,628	75,912,066	100.82	108.88	TP
	Uji i humbur	m ³	43,697,413	35,411,543	44,177,223	101.10	124.75	JR
	Uji i faturuar	m ³	31,596,804	34,307,086	31,734,843	100.44	92.50	JR
	Konsumatorët	Nr	326,143	354,019	342,792	105.10	96.83	P


2.1 Paraqitja grafike e ujit të prodhuar, të humbur, të faturuar në m³ dhe numrit të konsumatorëve

Të dhënat e tabelës Nr. 1. janë paraqitur grafikisht përmes grafikoneve të cilat mundësojnë krahasimin vizual të të dhënave historike për gjashtëmuajorin e vitit 2017, me të dhënat e aprovuara nga ARRU dhe të dhënat e realizuara nga KRU-të për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2018.


Uji i prodhuar në m³




Uji i humbur në m³



Uji i faturuar në m³



Konsumatorët



Nga tabela numër 1 vërejmë se në baza sektoriale prodhimi në total ka tejkaluar sasinë e prodhimit të aprovuar nga ARRU, për 6,193,438 m³, ose 8.88% tejkalim i planifikimit.

Po kështu sektori ka shënuar rritje prodhimi në raport me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, për 617,850 m³, ose 0.82% tejkalim planit të aprovuar.

Tejkalimin më të madh të caktit në prodhimin e ujit nga të gjitha kompanitë (shprehur në %-je) e ka arritur KRU Mitrovica, e cila ka tejkaluar caktin e aprovuar nga ARRU për 38.28%, pastaj vjen KRU Hidrodrini nga Peja me tejkalim të caktit të aprovuar nga ARRU me 12.18%, dhe KRU Bifurkacioni me tejkalim prej 111.03%.

Janë vënë në dispozicion burime të reja të prodhimit ose menaxhimit nga disa KRU, që pa mëdyshje ndikuan në rritjen e prodhimit dhe tejkalimin e caktit, por kjo diferencë do të analizohet pas përfundimit të vitit fiskal dhe auditimit të dhënave nga KRU-të.

Në nivel sektori uji i humbur është tregues alarmues, sepse sektori shënoi humbje uji për 44,177,223 m³. Raporti referues flet për 1.1 % më shumë ujë të humbur në raport me vitin e kaluar. Zvogëlimi i humbjeve të ujit krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak ka shënuar rritje prej 479,810 m³.

Të dhënat e raportuara nga KRU-të për humbjet e ujit kur krahasohen me të dhënat e aprovuara nga ARRU për gjashtë mujorin e parë të vitit 2018, rezulton se humbjet e realizuara janë për 8,765,680 m³ më shumë sesa ato që ka aprovuar Rregullatori, shprehur në përqindje kjo është 24.75%.

Kjo është njëra nga sfidat më të mëdha për sektorin dhe ARRU-në. Veçanërisht mos adresimi i humbjeve të ujit është alarmant dhe se kjo zgjidhje kërkon analiza shitesë nga KRU-të dhe ARRU-ja. Një ndihmesë e madhe do të ishte vendosja e ujëmatësve digjital tek çdo njësi prodhimi dhe mandej vendosja e matësve zonal, aplikimi i zbuluesve të derdhjeve dhe kontrollet e shtuara në terren.

Faturimi është njëri nga indikatorët matës të realizimit të caktit. Sektori ka arritur që ta faturojë 138,040 m³ më shumë sesa në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, ose 0.44 % më shumë, por sektori ka dështuar në arritjen e caktit për 7.5%.

3. ANALIZA E SHPENZIMEVE OPERATIVE

Nga të sipërthënat, gjatë procesit tarifar 2018-2020, ARRU ka kërkuar nga KRU-të të jenë më të kujdesshme me shpenzimet e tyre të drejtpërdrejta operative dhe ka kërkuar që të njëjtat të ulen deri në nivelin e arsyeshëm.

Të dhënat e shpenzimeve operative të paraqitura në këtë raport janë kategorizuar konform udhëzimeve të kontabilitetit rregullator, fillimisht duke i ndarë shpenzimet operative për ujë dhe ujëra të ndotura.

Shpenzimet direkte operative lidhur me ofrimin e shërbimeve përfshijnë: fuqinë punëtore të angazhuar; energjinë elektrike; kemikaljet; materiet konsumuese; shpenzimet e përbashkëta; taksat e pa-rimbursueshme dhe shpenzimet tjera.

Sipas UKRR, shpenzimet operative i ndajmë në tre kategori:

- shpenzimet operative në resurse dhe trajtim
- shpenzimet operative në distribuim-shpërndarje, dhe
- shpenzimet operative në aktivitete biznesore

Ndërkaq, shpenzimet operative për ujëra të ndotura, janë të ndara në 4 kategori, dhe atë:

- shpenzimet operative në grumbullimin e ujërave të ndotura
- shpenzimet operative në trajtimin e ujërave të ndotura
- shpenzimet operative në trajtimin e llumit
- shpenzimet operative në aktivitete biznesore

Për detaje më të hollësishme se cilat zëra të shpenzimeve operative futen në kategoritë përkatëse, mund të konsultoheni me Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullator, i cili gjendet i publikuar në ueb faqen zyrtare të ARRU (www.arru-rks.org).

3. 1 Shpenzimet operative për ujë dhe ujëra të ndotura

Në këtë tabelë janë të paraqitura shpenzimet operative për ujë dhe ujëra të ndotura për secilën KRU dhe sektorin, duke i paraqitur edhe shpenzimet operative historike për gjashtëmujorin e parë të vitit 2017, ato të aprovuara nga ARRU si dhe ato të realizuara nga KRU gjatë të njëjtës periudhë të gjashtëmujorit të parë të vitit 2018, të cilat janë vlerësuar me shkallën e përmbushjes së caqeve në % dhe me vlerësimin tonë përfundimtar për këtë periudhë kohore.

Tabela Nr. 2 Pasqyra e të dhënave të shpenzimeve operative për ujë dhe ujëra të ndotura në €

Emri i KRU	Zërat e shpenzimeve operative	Valuta	Historike 6m 2017	Aprovuara 6m 2018	Realizuara nga KRU-të 6m 2018	%krahasese 6m 2017 / 6m 2018	% real cak	Vlerësimi për 6m 2018
PR	Ujë	€	4,302,279	5,187,279	4,349,112	101.09	83.84	TP
	Ujëra të Ndotura	€	131,380	331,294	124,387	94.68	37.55	TP
	Totali	€	4,433,659	5,518,573	4,473,499	100.90	81.06	TP
PZ	Ujë	€	1,468,088	1,562,774	1,416,743	96.50	90.66	TP
	Ujëra të Ndotura	€	285,557	230,421	214,993	75.29	93.30	TP
	Totali	€	1,753,645	1,793,196	1,631,736	93.05	91.00	TP
PE	Ujë	€	1,133,384	1,182,085	1,106,453	97.62	93.60	TP
	Ujëra të Ndotura	€	75,821	91,977	69,182	91.24	75.22	TP
	Totali	€	1,209,205	1,274,062	1,175,635	97.22	92.27	TP
MIT	Ujë	€	1,357,279	1,102,236	1,364,024	100.50	123.75	JR
	Ujëra të Ndotura	€	173,673	121,017	167,010	96.16	138.01	JR
	Totali	€	1,530,951	1,223,253	1,531,033	100.01	125.16	JR
GJA	Ujë	€	1,371,140	1,340,724	1,377,391	100.46	102.73	P
	Ujëra të Ndotura	€	50,577	264,736	54,534	107.82	20.60	TP
	Totali	€	1,421,717	1,605,460	1,431,925	100.72	89.19	TP
FE	Ujë	€	641,084	740,968	631,655	98.53	85.25	TP
	Ujëra të Ndotura	€	146,298	154,903	153,950	105.23	99.38	R
	Totali	€	787,382	895,871	785,605	99.77	87.69	TP
GJI	Ujë	€	707,040	830,905	728,705	103.06	87.70	TP
	Ujëra të Ndotura	€	69,768	86,368	71,248	102.12	82.49	TP
	Totali	€	776,808	917,273	799,953	102.98	87.21	TP
Sektori	Ujë	€	10,980,294	11,946,972	10,974,083	99.94	91.86	TP
	Ujëra të Ndotura	€	933,074	1,280,715	855,303	91.67	66.78	TP
Totali i përgjithshëm		€	11,913,367	13,227,687	11,829,387	99.30	89.43	TP

Nga totali i shpenzimeve operative që kanë ndodhur për gjashtëmujorin e parë të vitit 2018, 92.78% të shpenzimeve u shënuan në shërbimin e ujit, ndërsa 7.22 % janë shpenzime të ujërave të ndotura.


Është tejet pozitive fakti që sektori ka arritur që të ketë më pak shpenzime operative sesa planifikimi, dhe atë për 1,398,301 €, ose 10.57% më pak se planifikimi.

Brengosëse është KRU Mitrovica, e cila është e vetmja kompani që nuk ka arritur cakun, madje për 25.16%.


Inkurajojmë KRU-të që të përpiqen që t'i ulin shpenzimet operative edhe më tej, sepse kjo ndikon në qëndrueshmërinë financiare të kompanisë si dhe krijohen mundësitë për përtëritjen e aseteve nëntokësore.

3.2 Paraqitja grafike e shpenzimeve operative për ujë dhe ujëra të ndotura


Shpenzimet operative për ujë



Shpenzimet operative për ujëra të ndotura



Përqindja e realizimit të shpenzimeve operative nga KRU-të



4. ANALIZA E FATURIMIT DHE ARKËTIMIT NË VLERË FINANCIARE

Të dhënat për faturim dhe arkëtim në vlerë financiare janë paraqitur, po ashtu në formë tabelore, për krahasim më të lehtë, të rezultateve të arritura nga secila kompani në veçanti dhe sektorit në përgjithësi. Në analizë hynë të dhënat historike të realizuara për gjashtëmujorin e parë të vitit 2017, pastaj të dhënat e aprovuara nga ARRU dhe ato të realizuara nga KRU-të gjatë të njëjtës periudhë të gjashtëmujorit të parë të vitit 2018, sipas procesit rregullator të përcaktimit të tarifave të viteve 2018-2020.

Edhe këto të dhëna do të paraqiten sipas shërbimeve të ofruara; ndaras për shërbimet e ujit dhe ndaras për shërbimet e ujërave të ndotura dhe pastaj të përmbledhura do të paraqiten të dhënat e aprovuara për çdo kompani veç e veç dhe për sektorin si tërësi përgjatë periudhës së shikuar për gjashtëmujorin e parë të vitit 2018 dhe për krahasime do të pasqyrohen edhe të dhënat e realizuara gjatë të së njëjtës periudhë të këtij viti, me të dhënat historike për periudhën e njëjtë kohore të gjashtëmujorit të vitit 2017.

Sipas politikave tarifore, të cilat janë publikuar nga ARRU në Maj të vitit 2017, faturimi dhe arkëtimi nga tarifa fikse dhe volumetrike për ujë i atribuohet shërbimeve të ujësjellësit, ndërsa tarifa volumetrike për ujëra të ndotura i atribuohet si e vetme për shërbimin e ujërave të ndotura.

Duke pasur parasysh se jo të gjitha KRU-të kanë qenë në gjendje të bëjnë ndarjen e arkëtitimit për ujë dhe ato për ujëra të ndotura, ARRU ka qenë e detyruar që të bëjë këtë ndarje sipas vlerësimit të ARRU. Kjo ndarje është bazuar në faturimin e planifikuar sipas BPRR të aprovuar nga ARRU-KRU dhe ato të realizuara nga KRU-të dhe sektorit të cilit i takojnë.

Kompanitë duhet që ta dizajnojnë softuerin financiar për t'i ndarë arkëtimet e sipër referuara, e cila gjë nuk kërkon kosto shtesë dhe lehtëson edhe raportimet menaxheriale, të vlefshme për vendimmarrje.

Shënim:

Duhet theksuar se për KRU "Mitrovica" sh. a – Mitrovicë, Qeveria e Republikës së Kosovës ndan mjete nga Buxheti i saj çdo vit (subvencione), që nga pas lufta, për të mbuluar një shumë të caktuar të shpenzimeve operative të cilat krijohen me rastin e furnizimit me ujë të pjesës Veriore të Qytetit të Mitrovicës. Në mënyrë që vlerësimi i ARRU-ës të jetë real, të dhënat e më poshtme i atribuohen të dy zonave të shërbimit (Jugore dhe Veriore), dhe si të tilla do të identifikohen aty ku është e mundur (faturimi e arkëtimi) për periudhat e shikuara.

4.1. Shuma e faturimit për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura

Në këtë tabelë është paraqitur faturimi i shërbimeve të ujit dhe ujërave të ndotura në vlerë monetare, për të dhënat historike për gjashtëmujorin e parë të vitit 2017, ato të aprovuara nga ARRU dhe të realizuara nga KRU-të dhe sektori për gjashtëmujorin e parë të vitit 2018.

Tabela Nr. 3 Pasqyra e të dhënave të faturimit për ujë dhe ujërave të ndotura në vlerë financiare

Emri i KRU	Të dhënat e faturimit	Njësia	Historike 6m 2017	Aprovuara 6m 2018	Realizuara nga KRU-të 6m 2018	%krahases e 6m 2017 / 6m 2018	% real cak	Vlerësimi për 6m 2018
PR	Ujë	€	6,216,036	6,978,667	6,401,889	102.99	91.74	JR
	Ujëra të Ndotura	€	603,118	650,443	608,652	100.92	93.57	JR
	Totali	€	6,819,154	7,629,110	7,010,541	102.81	91.89	JR
PZ	Ujë	€	1,773,172	2,009,259	1,469,118	82.85	73.12	JR
	Ujëra të Ndotura	€	213,141	326,608	271,707	127.48	83.19	JR
	Totali	€	1,986,313	2,335,867	1,740,825	87.64	74.53	JR
PE	Ujë	€	1,545,239	1,665,699	1,603,210	103.75	96.25	P
	Ujëra të Ndotura	€	167,124	187,982	191,797	114.76	102.03	TP
	Totali	€	1,712,363	1,853,681	1,795,007	104.83	96.83	P
MIT	Ujë-Jugu	€	1,416,051	1,277,891	1,370,956	96.82	107.28	TP
	Ujë-Veriu	€	421,271	377,730	409,906	97.30	108.52	TP
	Ujëra të Ndotura	€	266,339	213,148	244,580	91.83	114.75	TP
	Totali¹	€	1,682,390	1,491,039	1,615,536	96.03	108.35	TP
GJA	Ujë	€	1,772,140	1,883,063	1,640,027	92.54	87.09	JR
	Ujëra të Ndotura	€	253,364	347,902	308,469	121.75	88.67	JR
	Totali	€	2,025,504	2,230,965	1,948,497	96.20	87.34	JR
FE	Ujë	€	801,459	929,269	866,721	108.14	93.27	JR
	Ujëra të Ndotura	€	215,839	228,984	223,530	103.56	97.62	P
	Totali	€	1,017,298	1,158,253	1,090,251	107.17	94.13	P
GJI	Ujë	€	868,549	1,062,158	933,225	107.45	87.86	JR
	Ujëra të Ndotura	€	162,292	161,857	167,308	103.09	103.37	TP
	Totali	€	1,030,841	1,224,015	1,100,533	106.76	89.91	JR
Sektori	Ujë	€	14,813,918	16,183,736	14,695,052	99.20	90.80	JR
	Ujëra të Ndotura	€	1,881,217	2,116,925	2,016,044	107.17	95.23	P
Totali sektorial		€	16,695,134	18,300,661	16,711,095	100.10	91.31	JR

Është e rëndësishme të theksohet se në sektorin e ujit në Kosovë për këtë periudhë kohore, 87.93 % të shumës së faturimit në vlerë financiare realizohet nga shërbimi i ujit, ndërsa 12.07 % nga shërbimi i ujërave të ndotura. Në total për sektorin, për gjashtëmujorin e parë të vitit 2018 është realizuar faturimi në vlerë prej 16,711,095.00€, e që paraqet 91.31 % të shumës së aprovuar nga procesi rregullator për këtë periudhë kohore. Caku nuk është arritur për 8.69%.

Në këtë gjashtëmujor, sektori ka shënuar një rritje jo të ndjeshme të faturimit në kumulativ për ujë dhe ujëra të zeza, për vetëm 0.1 %, në raport me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.


¹ Për vlerësimin e përbushjes së caktit të KRU "Mitrovica", totali nuk përmban sasinë e faturimit për pjesën veriore të qytetit. Por, për të genë të informuar palët e interesit për sasinë e ujit të faturuar në atë pjesë, ne e kemi vendosur vetëm si shifër ilustrative.

Ndërkaq, sektori ka dështuar në arritjen e caktit për faturimin e ujit për 1,623,047 €, ose dështim të caktit për 9.2%, gjë që është brengosëse. Për Ujëra të ndotura sektori ka shënuar rritje në raport me të njëjtën periudhë të vitit paraprak prej 134,827.00 €, kurse ka ngecje në raport me planin e aprovuar në vlerë financiare prej 100,881.00€. Sektori ka arritur që të përafrohet me realizimin e caktit.


Në tërësi, sektori së bashku ujë dhe ujëra të ndotura ka tejkaluar vitin paraprak për 15,961 €, ose tejkalim për 0.1%, kurse ka ngecje në realizimin e caktit për 1,589,566 € ose mosrealizim të caktit prej 8.69%, që është brengosëse dhe inkurajojmë KRU-të që të ndërmarrin veprimet e duhura për realizimin e caktit deri në fund të vitit.

4.2 Paraqitja grafike e faturimit për ujë dhe ujëra të ndotura


Faturimi për ujë në euro



Faturimi për ujëra të zeza në euro



Përqindja e realizimit të faturimit në Euro



4.3. Shuma e arkëtimit për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura

Në këtë tabelë është paraqitur arkëtimi për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura në vlerë financiare, për të dhënat historike për gjashtëmujorin e vitit 2017, ato të aprovuara nga ARRU dhe të realizuara nga KRU-të për gjashtëmujorin e parë të vitit 2018.

Tabela Nr. 4 Shumat e arkëtimit për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura në vlerë financiare

Emri i KRU	Arkëtimi për shërbimet përkatëse	Njësia	Historike 6m 2017	Aprovuara 6m 2018	Realizuara nga KRU-të 6m 2018	% krahasuese 6m 2017 / 6m 2018	% real cak	Vlerësimi për 6m 2018
PR	Ujë	€	5,331,577	6,377,937	6,207,551	116.43	97.33	P
	Ujëra të Ndotura	€	571,134	599,101	590,176	103.33	98.51	R
	Totali	€	5,902,712	6,977,038	6,797,727	115.16	97.43	P
PZ	Ujë	€	1,642,929	1,784,027	1,572,087	95.69	88.12	JR
	Ujëra të Ndotura	€	197,327	295,064	239,367	121.30	81.12	JR
	Totali	€	1,840,256	2,079,091	1,811,454	98.43	87.13	JR
PE	Ujë	€	1,167,185	1,427,558	1,232,311	105.58	86.32	JR
	Ujëra të Ndotura	€	127,014	167,196	147,425	116.07	88.18	JR
	Totali	€	1,294,199	1,594,754	1,379,737	106.61	86.52	JR
MIT	Ujë	€	652,737	968,795	874,322	133.95	90.25	JR
	Subvencionet	€	86,895	377,683	90,000	103.57	23.83	JR
	Ujërat e ndotura	€	139,722	165,451	155,980	111.64	94.28	P
	Totali²	€	792,459	1,134,246	1,030,302	130.01	90.84	JR
GJA	Ujë	€	1,413,167	1,650,384	1,502,182	106.30	91.02	JR
	Ujëra të Ndotura	€	202,379	309,363	282,543	139.61	91.33	JR
	Totali	€	1,615,545	1,959,747	1,784,725	110.47	91.07	JR
FE	Ujë	€	507,008	793,658	595,240	117.40	75.00	JR
	Ujëra të Ndotura	€	141,948	196,156	153,514	108.15	78.26	JR
	Totali	€	648,956	989,814	748,754	115.38	75.65	JR
GJI	Ujë	€	631,116	929,020	718,219	113.80	77.31	JR
	Ujëra të Ndotura	€	117,290	142,393	128,762	109.78	90.43	JR
	Totali	€	748,406	1,071,413	846,981	113.17	79.05	JR
Sektori	Ujë	€	11,345,720	13,931,378	12,701,913	111.95	91.17	JR
	Ujëra të Ndotura	€	1,496,815	1,874,724	1,697,766	113.43	90.56	JR
Totali i përgjithshëm		€	12,842,534	15,806,103	14,399,680	112.12	91.10	JR

Për sektorin e ujit në Kosovë, sipas vlerësimeve të ARRU-së për gjashtëmujorin e vitit 2018, 88.20 % e arkëtimit rrjedh nga shërbimi i ujit, ndërsa pjesa tjetër prej 11.80 % rrjedh nga shërbimi i ujërave të ndotura. Në total, në gjashtëmujorin e parë të vitit 2018 është realizuar arkëtimi në vlerë prej 14,399,680.00€, e që shprehë përmbushjen e caktut prej 91.10 % të shumës së aprovuar për gjashtëmujorin e parë të vitit 2018.



Sektori me arkëtim për ujë ka realizuar 12,701,913.00 €, e që shënoi rritje në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar në vlerë prej 1,356,193.00€ ose për 11.95% dhe caku u arrit për 91.1%. Sektori në arkëtimin e shërbimeve për ujëra të zeza ka inkasuar 1,697,766.00€, e që është 200,952.00€

² Subvencionet e dhëna nga Qeveria e Republikës së Kosovës për të mbuluar shpenzimet operative të KRU "Mitropvica", nuk përbëjnë totalin në këtë pikë, por ato janë vendosur vetëm si shifër ilustrative për të informuar palët e interesit.


më shumë se sa për të njëjtën periudhë kohore të vitit të kaluar, ose për 13.43% më shumë. Sektori, në këtë fushë nuk arriti ta realizojë cakun për 9.44%

Individualisht, asnjëra kompani nuk arriti cakun e realizimit. Megjithatë KRU Prishtina ka arritur që t'i përafrohet caktut për 2.57%, pason KRU Gjakova, që arriti t'i përafrohet caktut për 9.70%, etj.

4.4. Paraqitja grafike e arkëtimit për ujë dhe ujëra të ndotura



Përqindja e realizimit të arkëtimit në Euro



5. ANALIZA E INVESTIMEVE KAPITALE

Me aprovimin e tarifave të reja për periudhën afatmesme 2018-2020, ARRU-KRU kanë planifikuar realizimin e shumave të caktuara të investimeve, këto investime janë të domosdoshme në sistemet e ujësjellësit dhe ujërave të ndotura, të cilat pas realizimit do të mundësojnë shërbime më cilësore për konsumatorë.

Sipas UKRR-s, investimet kapitale janë klasifikuar si investime në **shërbimet ujësjellësit dhe shërbimet e ujërave të ndotura**.

I. Investimet në shërbimet e ujësjellësit:

- Investime në resurse dhe trajtim të ujit,
- Investime në distribuim, dhe
- Investime në aktivitete biznesore.

II. Investimet në shërbimet e ujërave të ndotura:

- Investime në grumbullimin e ujërave të ndotura,
- Investime në trajtimin ujërave të ndotura,
- Investime në trajtimin dhe derdhjen e llumit, dhe
- Investime në aktivitete biznesore

Investimet në asetet e ujësjellësit dhe ujërave të ndotura janë ndarë në: **asete të infrastrukturës dhe ato të jo-infrastrukturës**

Investimet kapitale në **Asetet Infrastrukturore** janë të ndara në investime: *(i)* të cilat bëhen për qëllime të përtëritjes infrastrukturës, *(ii)* dhe në investime të rritjes së infrastrukturës. Këto Investime karakterizohen si investime në asetet nëntokësore siç janë: gypat, pusetat, digat, rezervuarët nëntokësore, kanalet e ujit etj.

Investimet kapitale në **Asetet Jo-Infrastrukturore** bëjnë pjesë të gjitha investimet në asetet mbitokësore siç janë: *(i)* fabrikat për trajtimin e ujit, *(ii)* ndërtesat administrative, *(iii)* mjetet transportuese, *(iv)* pajisjet për zyrë etj. Ky grup i investimeve mandej kategorizohet në investime të mirëmbajtjes kapitale dhe rritjes së jo-infrastrukturës.

Për t'u njoftuar më në detaje për këto kategorizime mund të gjenden shpjegime në UKRR të cilat janë të publikuara në ueb faqen zyrtare të ARRU.

5.1. Shumat e Investimeve kapitale nga burimet e vetëfinancimit

Në tabelën e më poshtme paraqiten shumat e investimeve kapitale me financim nga burimet e kompanive për kategorinë e shërbimeve të ujësjellësit për gjashtëmujorin e parë të vitit 2018. Me këtë bëhet krahasimi i shumave të investimeve kapitale të aprovuara nga ARRU me ato të realizuara nga KRU-të për gjashtëmujorin e parë të vitit 2018, % e realizimit të investimeve të planifikuara dhe vlerësimin tonë përfundimtar.

Tabela Nr. 5. Shumat e investimeve kapitale për ujë të financuar nga burimet e KRU sipas kategorive të theksuara ma lartë për gjashtëmujorin e vitit 2018 shprehur në €

Emri i KRU	Kategori të Investimeve	Aprovuara 6m 2018	Realizuara nga KRU-të 6m 2018	% krahasuese 6m 2017 / 6m 2018	% real cak
PR	Resurse dhe trajtimi i ujit	20,096.6	945,489	4704.72	PK
	Distribuim	151,729.5	33,724	22.23	JR
	Aktivitetet biznesore	23,362	5,923	25.35	JR
	Totali	195,188	985,136	504.71	PK
PZ	Resurse dhe trajtimi i ujit	84,707.2	4,576	5.40	JR
	Distribuim	146,695.9	127,669	87.03	JR
	Aktivitetet biznesore	15,072	27,098	179.78	PK
	Totali	246,476	159,343	64.65	JR
PE	Resurse dhe trajtimi i ujit	0.0	0	!	PK
	Distribuim	232,618.4	0	0.00	JR
	Aktivitetet biznesore	13,364	0	0.00	JR
	Totali	245,983	0	0.00	JR
MIT	Resurse dhe trajtimi i ujit	0.0	0	!	PK
	Distribuim	150,724.6	0	0.00	JR
	Aktivitetet biznesore	0	0	!	PK
	Totali	150,725	0	0.00	JR
GJA	Resurse dhe trajtimi i ujit	200,966.2	529,364	263.41	PK
	Distribuim	155,430.8	125,575	80.79	JR
	Aktivitetet biznesore	114,149	51,797	45.38	JR
	Totali	470,546	706,736	150.19	PK
FE	Resurse dhe trajtimi i ujit	0.0	0	!	PK
	Distribuim	7,536.2	254	3.37	JR
	Aktivitetet biznesore	15,072	122	0.81	JR
	Totali	22,609	376	1.66	JR
GJI	Resurse dhe trajtimi i ujit	25,120.8	380	1.51	JR
	Distribuim	60,289.9	0	0.00	JR
	Aktivitetet biznesore	0	2,591	!	PK
	Totali	85,411	2,971	3.48	JR
Sektori	Resurse dhe trajtimi i ujit	330,891	1,479,809	447.22	PK
	Distribuim	905,025	287,222	31.74	JR
	Aktivitetet biznesore	181,020	87,531	48.35	JR
	Totali	1,416,936	1,854,563	130.89	PK

Tabela Nr. 6. Shumat e investimeve kapitale për ujëra të ndotura të financuar nga burimet e vetëfinancimit të kompanive sipas kategorive të theksuara më lartë për gjashtëmujorin e vitit 2018 shprehur në €


Emri i KRU	Kategori të Investimeve	Aprovuara 6m 2018	Realizuara nga KRU-të 6m 2018	% krahasuese 6m 2017 / 6m 2018	% real cak
PR	Grumbullimi i u.n	4,521.7	0	0.00	JR
	Trajtim i u.n	0.0	0	!	PK
	Trajtimi i llumit	125,603.9	0	0.00	JR
	Aktivite biznese	1,758.5	183	10.40	JR
	Totali	131,884	183	0.14	JR
PZ	Grumbullimi i u.n	38,233.8	25,000	65.39	JR
	Trajtim i u.n	0.0	0	!	PK
	Trajtimi i llumit	0.0	0	!	PK
	Aktivite biznese	23,111.1	0	0.00%	JR
	Totali	61,344.9	25,000	40.75%	JR
PE	Grumbullimi i u.n	0.0	0	!	PK
	Trajtim i u.n	0.0	0	!	PK
	Trajtimi i llumit	40,193.2	0	0.00	JR
	Aktivite biznese	703.4	0	0.00	JR
	Totali	40,896.6	0	0.00	JR
MIT	Grumbullimi i u.n	0.0	0	!	PK
	Trajtim i u.n	0.0	0	!	PK
	Trajtimi i llumit	25,120.8	0	0.00	JR
	Aktivite biznese	0.0	0	!	PK
	Totali	25,120.8	0	0.00	JR
GJA	Grumbullimi i u.n	22,608.7	0	0.0	JR
	Trajtim i u.n	0.0	0	!	PK
	Trajtimi i llumit	0.0	0	!	PK
	Aktivite biznese	6,430.9	0	0.00	JR
	Totali	29,039.6	0	0.00	JR
FE	Grumbullimi i u.n	20,096.6	0	0.00	JR
	Trajtim i u.n	0.0	0	!	PK
	Trajtimi i llumit	25,120.8	0	0.00	JR
	Aktivite biznese	15,072.5	31	0.20	JR
	Totali	60,289.9	31	0.05	JR
GJI	Grumbullimi i u.n	25,120.8	0	!	PK
	Trajtim i u.n	0.0	0	!	PK
	Trajtimi i llumit	0.0	0	0.00	JR
	Aktivite biznese	0.0	0	!	PK
	Totali	25,121	0	0.00	JR
SEKTORI	Grumbullimi i u.n	85,461	25,000	29.25	JR
	Trajtim i u.n	0	0	!	PK
	Trajtimi i llumit	241,159	0	0.00	JR
	Aktivite biznese	47,076	213	0.45	JR
	Totali	373,697	25,213	6.75	JR

Tabela Nr. 7. Shumat e Investimeve kapitale të financuara nga burimet e vetëfinancimit të kompanive për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura për gjashtëmujorin e vitit 2018.


Emri i KRU	Investimet në shërbimet përkatëse	Njësia	Historike 6m 2017	Aprovuara 6m 2018	Realizuar a nga KRU-të 6m 2018	% krahasuese 6m 2017 / 6m 2018	% real cak	Vlerësimi për 6m 2018
PR	Ujë	€	64,520	195,188	985,136	1526.86	504.71	PK
	Ujëra të ndotura	€	117	131,884	183	156.32	0.14	JR
	Totali	€	64,637	327,072	985,319	1524.38	301.25	PK
PZ	Ujë	€	53,384	246,476	159,343	298.48	64.65	JR
	Ujëra të ndotura	€	3,278	61,345	25,000	762.70	40.75	JR
	Totali	€	56,662	307,821	184,343	325.34	59.89	JR
PE	Ujë	€	0	245,983	0	!	!	PK
	Ujëra të ndotura	€	0	40,897	0	!	!	PK
	Totali	€	0	286,879	0	!	!	PK
MIT	Ujë	€	0	150,725	0	!	!	PK
	Ujëra të ndotura	€	0	25,121	0	!	!	PK
	Totali	€	0	175,845	0	!	!	PK
GJA	Ujë	€	699,982	470,546	706,736	100.96	150.19	PK
	Ujëra të ndotura	€	7,965	29,040	0	0.00	!	PK
	Totali	€	707,947	499,585	706,736	99.83	141.46	PK
FE	Ujë	€	4,507	22,609	376	8.35	1.66	JR
	Ujëra të ndotura	€	0	60,290	31	!	0.05	JR
	Totali	€	4,507	82,899	407	9.03	0.49	JR
GJI	Ujë	€	7,818	85,411	2,971	38.00	3.48	JR
	Ujëra të ndotura	€	304	25,121	0	0.00	!	PK
	Totali	€	8,122	110,531	2,971	36.58	2.69	JR
SEKTORI	Ujë	€	830,211	1,416,936	1,854,563	223.38	130.89	PK
	Ujëra të ndotura	€	11,663	373,697	25,213	216.18	6.75	JR
Totali i përgjithshëm		€	841,875	1,790,633	1,879,776	223.28	104.98	PK

5.2. Paraqitja grafike e të dhënave për investime kapitale nga burimet e vetëfinancimit të kompanive


Investimet vetanake për ujë



Investimet vetanake për ujëra të zeza



Përqindja e realizimit të investimeve vetanake në €



5.3. Shumat e investimeve kapitale të financuara nga donatorët

Në këtë tabelë paraqiten të dhënat e shumave të aprovuara dhe realizuara nga financimet e donatorëve, të cilët kanë qenë pjesë të planifikimit të projekteve për realizim të investimeve kapitale për shërbimet e ujit për gjashtëmuorin e parë të vitit 2018. Krahasimi i këtyre të dhënave pasqyron shkallën e përbushjes së objektivave të përcaktuara për këtë periudhë kohore, të cilat epen në % me vlerësimin përfundimtarë.

Tabela Nr. 8. Shumat e investimeve kapitale për ujë të financiar nga donatorët sipas kategorive të theksuara më lartë për gjashtëmuorin e vitit 2018 shprehur në €.

Emri i KRU	Kategori të Investimeve	Aprovuara 6m 2018	Realizuara nga KRU-të 6m 2018	% krahasuese 6m 2017 / 6m 2018	% real cak
PR	Resurse dhe trajtimi i	0.0	0	!	PK
	Distribuim	2,512.1	0	0.00	JR
	Aktivitetet biznesore	18,689.9	0	0.00	JR
	Totali	21,201.9	0	0.00	JR
PZ	Resurse dhe trajtimi i	0.0	1,186	!	PK
	Distribuim	3,191,801.8	125,337	3.93	JR
	Aktivitetet biznesore	12,058.0	0	0.00	JR
	Totali	3,203,859.8	126,523	3.95	JR
PE	Resurse dhe trajtimi i	0.0	0	!	PK
	Distribuim	0.0	0	!	PK
	Aktivitetet biznesore	0.0	0	!	PK
	Totali	0.0	0	!	PK
MIT	Resurse dhe trajtimi i	1,271,111.1	0	0.00	JR
	Distribuim	578,140.3	603,761	104.43	PK
	Aktivitetet biznesore	42,705.3	18,930	44.33	JR
	Totali	1,891,956.7	622,691	32.91	JR
GJA	Resurse dhe trajtimi i	527,536.2	84,746	16.06	JR
	Distribuim	69,986.5	104,965	149.98	PK
	Aktivitetet biznesore	119,323.7	0	0.00	JR
	Totali	716,846.4	189,711	26.46	JR
FE	Resurse dhe trajtimi i	150,724.6	0	0.00	JR
	Distribuim	140,676.3	0	0.00	JR
	Aktivitetet biznesore	0.0	0	!	PK
	Totali	291,401.0	0	0.00	JR
GJI	Resurse dhe trajtimi i	969,661.8	0	0.00	JR
	Distribuim	0.0	0	!	PK
	Aktivitetet biznesore	0.0	0	!	PK
	Totali	969,662	0	0.00	JR
Sektori	Resurse dhe trajtimi i	2,919,034	85,932	2.94	JR
	Distribuim	3,983,117	834,063	20.94	JR
	Aktivitetet biznesore	192,777	18,930	9.82	JR
	Totali	7,094,928	938,925	13.23	JR

Tabela Nr.9. Shumat e investimeve kapitale për ujëra të ndotura të financuara nga donatorët sipas kategorive të theksuara ma lartë për gjashtëmujorin e vitit 2018 shprehur në €.


Emri i KRU	Kategori të Investimeve	Aprovuara 6m 2018	Realizuara nga KRU-të 6m 2018	% krahasuese 6m 2017 / 6m 2018	% real cak
PR	Grumbullimi i u.n	0	0	!	PK
	Trajtim i u.n	0	0	!	PK
	Trajtimi i llumit	0	0	!	PK
	Aktivitete biznesore	0	0	!	PK
	Totali	0	0	!	PK
PZ	Grumbullimi i u.n	1,125,411	0	0.00	JR
	Trajtim i u.n	2,514,087	0	0.00	JR
	Trajtimi i llumit	0	0	!	PK
	Aktivitete biznesore	0	0	!	PK
	Totali	3,639,498	0	0.00	JR
PE	Grumbullimi i u.n	0	0	!	PK
	Trajtim i u.n	0	0	!	PK
	Trajtimi i llumit	0	0	!	PK
	Aktivitete biznesore	602,899	0	0.00	JR
	Totali	602,899	0	0.00%	JR
MIT	Grumbullimi i u.n	236,670	0	0.00%	JR
	Trajtim i u.n	0	0	!	PK
	Trajtimi i llumit	0	0	!	PK
	Aktivitete biznesore	0	0	!	PK
	Totali	236,670	0	0.00	JR
GJA	Grumbullimi i u.n	0	0	!	PK
	Trajtim i u.n	2,813,527	0	0.00	JR
	Trajtimi i llumit	0	0	!	PK
	Aktivitete biznesore	6,280	0	0.00	JR
	Totali	2,819,807	0	0.00	JR
FE	Grumbullimi i u.n	150,725	0	0.00	JR
	Trajtim i u.n	0	0	!	PK
	Trajtimi i llumit	0	0	!	PK
	Aktivitete biznesore	0	0	!	PK
	Totali	150,725	0	0.00	JR
GJI	Grumbullimi i u.n	1,507,246	0	0.00	JR
	Trajtim i u.n	0	0	!	PK
	Trajtimi i llumit	0	0	!	PK
	Aktivitete biznesore	0	0	!	PK
	Totali	1,507,246	0	0.00	JR
SEKTORI	Grumbullimi i u.n	3,020,052	0	0.00	JR
	Trajtim i u.n	5,327,614	0	0.00	JR
	Trajtimi i llumit	0	0	!	PK
	Aktivitete biznesore	609,179	0	0.00	JR
	Totali	8,956,844	0	0.00	JR

Tabela Nr. 10. Shumat e investimeve kapitale të aprovuar dhe realizuar nga donatorët për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura për gjashtëmuorin e vitit 2018.


Emri i KRU	Investimet në shërbimet përkatëse	Njësia	Historike 6m 2017	Aprovuara 6m 2018	Realizuara nga KRU-të 6m 2018	% krahasuese 6m 2017 / 6m 2018	% real cak	Vlerësimi për 6m 2018
PR	Ujë	€	6,967	21,202	0	0.00	!	PK
	Ujëra të ndotura	€	0	0	0	!	!	PK
	Totali	€	6,967	21,202	0	0.00	!	PK
PZ	Ujë	€	160,902	3,203,860	126,523	78.63	3.95	JR
	Ujëra të ndotura	€	193,355	3,639,498	0	0.00	!	PK
	Totali	€	354,257	6,843,357	126,523	35.72	1.85	JR
PE	Ujë	€	0	0	0	!	!	PK
	Ujëra të ndotura	€	0	602,899	0	!	!	PK
	Totali	€	0	602,899	0	!	!	PK
MIT	Ujë	€	11,390,891	1,891,957	622,691	5.47	32.91	JR
	Ujëra të ndotura	€	0	236,670	0	!	!	PK
	Totali	€	11,390,891	2,128,627	622,691	5.47	29.25	JR
GJA	Ujë	€	1,117,266	716,846	189,711	16.98	26.46	JR
	Ujëra të ndotura	€	0	2,819,807	0	!	!	PK
	Totali	€	1,117,266	3,536,653	189,711	16.98	5.36	JR
FE	Ujë	€	81,806	291,401	0	0.00	!	PK
	Ujëra të ndotura	€	0	150,725	0	!	!	PK
	Totali	€	81,806	442,126	0	0.00	!	PK
GJI	Ujë	€	0	969,662	0	!	!	PK
	Ujëra të ndotura	€	0	1,507,246	0	!	!	PK
	Totali	€	0	2,476,908	0	!	!	PK
Sektori	Ujë	€	12,757,832	7,094,928	938,925	7.36	13.23	JR
	Ujëra të ndotura	€	193,355	8,956,844	0	0.00	!	PK
Totali i përgjithshëm		€	12,951,186	16,051,772	938,925	7.25	5.85	JR

5.4. Paraqitja grafike e të dhënave për investimet kapitale nga donatorët


Investimet nga donacionet për ujë



Investimet nga donacionet për ujëra të zeza



Përqindja e realizimit të investimeve nga donatorët në €



KAPITULLI 2

ANALIZË KRAHASUESE E KRU-ve


1. ANALIZA E HUMBJEVE TË UJIT

ARRU ka përdorur qasjen e humbjeve të ujit në m³ për konsumatorë në vit si dhe litër për konsumatorë në ditë. Aktualisht këtë metodikë e kemi konsideruar si më të arsyeshmen për t'i krahasuar kompanitë me njëra tjetrën në këtë cak. Megjithatë, në të ardhmen do të mundohemi që në bashkërendim me KRU-të të fusim edhe modalitete tjera relevante që ky indikator të jetë më kompetitiv.

Tabela. Nr. 1. Humbjet e ujit për metër gjatësi të gypave në gjashtëmujorin e vitit 2018

Emri i KRU	Prodhimi i ujit në m3	Humbjet e ujit në m3 realizuar nga KRU	% e humbjeve të ujit
PR	26,226,051	15,396,494	58.71
PZ	8,177,949	4,671,927	57.13
PE	12,684,767	8,088,040	63.76
MIT	13,861,596	6,151,914	61.78
GJA	6,909,501	3,051,863	44.17
FE	3,898,532	2,215,311	56.82
GJI	4,153,670	2,190,462	52.74
Spektori	75,912,066	41,766,011	58.20

Kompania e cila ka humbje më të mëdha si përqindje, është KRU "Hidrodrini", e që shprehur në përqindje është 63.76%, kurse pas saj vjen KRU "Mitrovica" me 61.78 % etj.




2. KTHIMI I UJIT NË PARA

Diagrami i më poshtëm paraqet në mënyrë grafike efikasitetin e secilës KRU në Kosovë, se sa arrijnë ato, të kthejnë në para sasinë e ujit të prodhuar në m³.

Për thjeshtim, shfrytëzuesi/lexuesi mund ta kuptojë edhe vizualisht, përmes grafikunit të mëposhtëm, efikasitetin e KRU-ve në këtë kontekst. Shtylla me ngjyrë të kaltër paraqet prodhimin e ujit në m³, kurse shtylla me ngjyrë të gjelbër tregon sasinë e ujit që faturohet. Diferenca ndërmjet këtyre dy elementeve paraqet sasinë e ujit të humbur. Kurse kolona me ngjyrë kafe paraqet sasinë e ujit në m³ që kthehet në para. Diferenca në mes kolonës me ngjyrë të gjelbër dhe asaj me ngjyrë kafe paraqet llogaritë e arkëtueshme të pa mbledhshme.

Kthimi i ujit në para



3. SHPENZIMET E PAGAVE

Pa mëdyshje se kostoja e pagave për të punësuarit në të gjitha KRU-të paraqet shumën më të lartë nga gjithsej shpenzimet operative.

Tabela në vijim paraqet shpenzimet totale operative me shpenzimet e pagave për këtë periudhë kohore. Po ashtu, për të analizuar efikasitetin e stafit janë paraqitur numri i punëtorëve në raport me 1,000 konsumatorë, për secilën kompani veç e veç dhe për sektorin në tërësi.

Tabela Nr. 2. Shpenzimet e pagave në raport me shpenzimet totale për gjashtëmuajorin e vitit 2018

Emri i KRU	Totali i shpenzimeve operative të realizuara	Shpenzimet e pagave të realizuara	Përqindja e pagave në raport me shpenzimet e realizuara	Paga mesatare mujore	Numri i të punësuarve	Nr. Punëtorëve për 1000 konsumatorë
	€	€	%	€/muaj	Nr	(nr / '000 k.)
PR	4,473,499	2,388,893	53.40	735	542	4.18
PZ	1,631,736	997,315	61.12	508	327	6.99
PE	1,175,635	767,023	65.24	600	213	4.63
MIT	1,531,033	740,584	48.37	500	247	8.14
GJA	1,431,925	1,039,016	72.56	658	263	7.27
FE	785,605	584,029	74.34	477	204	7.58
GJI	799,953	559,553	69.95	565	165	6.12
Sektori	11,829,387	7,076,412	59.82	601	1,961	5.72

Kjo analizë vë në pah se KRU-ja që ka pagën më të lartë në sektor është KRU "Prishtina" por që e njëjta ka efikasitetin më të lartë për numër të punëtorëve në 1000 konsumatorë. Kjo nënkupton se KRU "Prishtina" ka arritur të menaxhoj ofrimin e shërbimeve të ujësjellësit dhe të kanalizimit me numër më të vogël të punëtorëve, duke rritur pagat e tyre.

Ndërkaq si KRU-të që kanë pagën më të vogël në sektor janë KRU "Mitrovica" dhe "Bifurkacioni". Me këtë vërehet se KRU "Mitrovica" ka përqindjen më të vogël të pagave në raport me totalin e shpenzimeve operative, për faktin se totali i shpenzimeve përmban edhe shumën e mjeteve financiare për blerje të ujit me shumicë nga Ibër- Lepenci.

Sa i përket pjesëmarrjes së pagave në totalin e shpenzimeve operative, KRU "Bifurkacioni", dhe "Gjakova" janë KRU-të që kanë pjesëmarrjen më të madhe të pagave në total të shpenzimeve, dhe atë në masën mbi 70%.

Në nivel sektori, paga mesatare për këtë periudhë kohore kap vlerën prej 601 €/muaj, kurse efikasiteti i stafit në nivel sektori është 5.72 punëtorë për 1,000 konsumatorë.

Konstatohet se, pagat në sektor shprehin pjesëmarrje me përqindje të lartë në shpenzimet operative të kompanive, me 59.82%. Po ashtu, analiza thekson mospërputhjen e rezultateve për njësi, në raport me pagat.

Sektori bënë punësime jo adekuate me profilin që ka nevojë më së shumti. Vërehet mungesë e konsiderueshme e hidro inxhinierëve, ndërkaq punësohen profile tjera.

Shpenzimet e pagave, bonuset, sigurimet shëndetësore si dhe vizitat jashtë vendit, madje edhe në vendet ku nuk janë kompatible me nevojën e praktikave të zbatueshme tek kompanitë e ujësjellësve, shprehin nevojën e një analize, në radhë të parë nga vetë kompanitë, pastaj nga aksionari dhe Rregullatori. Çdo punësim i ri dhe çdo rritje pagash, duhet të shoqërohet me kundërvlerën e rezultateve konkrete në kompani, shprehur në cilësi, sasi, standarde, avancim tekniko teknologjik, metodologji më të avancuar dhe afarizëm, i cili mundëson akumulim financiar për mirëmbajtje dhe investime.

4. SHPENZIMET E ENERGJISË ELEKTRIKE

Ofrimi i shërbime të ujësjellësit ndërthet në vete shpenzim të konsiderueshëm të energjisë elektrike. Kjo energji nevojitet për ekstraktimin e ujit nga burimet, trajtimin e tij, dërgimin e ujit në rezervuare akumulues dhe në raste të caktuara për distribuim të tij deri tek konsumatori. Kostoja e energjisë ndryshon, varësisht nga lloji i burimit që ka KRU-ja përkatëse, teknologjinë e trajtimit të ujit dhe vjetërsinë e FPU-së, kapacitetin e akumulimit, topografinë e terrenit, dhe madhësinë e sistemit. Shpenzimet e energjisë elektrike, pas zërit të pagave, përbëjnë zërin e parë në totalin e shpenzimeve operative.

Tabela Nr. 2. Shpenzimet e energjisë elektrike në raport me ato totale për gjashtëmujorin e 2018

Emri i KRU	Totali i shpenzimeve operative të realizuara	Shpenzimet e energjisë elektrike	Përqindja e energjisë elektrike në raport me shpenzimet	Energji €/1000 m ³ Prodhim	Energjia për numër të konsumatorëve
	€	€	%	€/1000 m ³	€/konsumatorë
PR	4,473,499	1,067,713	23.87	40.7	8.24
PZ	1,631,736	411,643	25.23	50.3	8.80
PE	1,175,635	221,025	18.80	17.4	4.80
MIT	1,531,033	330,295	21.57	23.8	10.88
GJA	1,431,925	132,618	9.26	19.2	3.67
FE	785,605	74,620	9.50	19.1	2.77
GJI	799,953	99,428	12.43	23.9	3.69
SEKTORI	11,829,387	2,337,342	19.76	30.8	6.82

Prej të dhënave të mësipërme si dhe nga të dhënat e shpenzimeve të pagave mund të kuptojmë se për sektorin e ujit në Kosovë, për gjashtëmujorin e vitit 2018, 59.82 % të shpenzimeve e përbëjnë pagat, me 19.76% energjia elektrike, kurse pjesa tjetër përbënë shpenzimet tjera operative.

Ndër KRU-të që ka shpenzimet më të vogla të energjisë elektrike për sasinë e ujit që ekstraktin është KRU “Bifurkacioni” dhe “Gjakova”, kurse si kompani që ka shpenzimet më të madhe të energjisë elektrike janë “Hidroregjioni-Jugor”(25.23%) dhe KRU “Prishtina”(23.87%), kjo si ndikim i konfiguracionit të terrenit, e cila imponon aktivizimin e pompave për shtyrje të ujit deri tek konsumatori.

Analiza e këtyre shpenzimeve, shpie në nevojën e avancimit të pajisjeve, dhe metodologjisë, e cila mundëson shpenzime më të ulëta të rrymës për njësinë e prodhimit dhe shpërndarjes.

Praktika e vendeve tjera ofron mundësinë e shfrytëzimit më efektiv të energjisë elektrike. Disa kompani kanë pasur edhe asistencë, nga donatorët, kurse praktikat e tilla nuk i kanë aplikuar me sukses, gjë që është brengosëse.

Inkurajojmë kompanitë që të bëjnë përpjekje për t’i zvogëluar këto shpenzime, duke absorbuar praktika më të mira dhe më eficiente.

KAPITULLI 3

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

1. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Nga të sipër theksuarat, duket qartë se treguesit kryesorë pasqyrojnë të dhëna të mospërbushjes së caqeve, me theks të veçantë uji i humbur në m³ dhe uji i faturuar në m³, sikurse nuk janë përmbushur edhe treguesit tjerë financiarë, siç është, arkëtimi dhe investimet kapitale.

Përfundimisht bëjnë shpenzimet operative, ku sektori ka përformuar mirë në krahasim me atë që ka aprovuar Rregullatori, ku rregullatori kishte për bazë planifikimin e ofruesve të shërbimeve se do ta rrisin bazën e shtrirjes në terren dhe se kjo nënkuptonte dhe kosto shtesë. Kjo ishte arsyeja se rregullatori kishte planifikuar më shumë shpenzime operative.

Megjithatë, brengosëse është se fondi i pagave i cili ka pjesëmarrje të lartë në shpenzimet operative, kurse kjo nuk shprehet në mënyrë ekuivalente në rezultatet e punës dhe performancën e kompanive.

Në disa kompani pjesëmarrja e pagave në shpenzimet operative është mbi 70% dhe se kjo nuk do koment, por do vetëm masa vepruese për ta ndryshuar gjendjen.

Në nivel sektori, paga mesatare për këtë periudhë kohore kap vlerën prej 601 €/muaj, kurse efikasiteti i stafit në nivel sektori është 5.72 punëtorë për 1,000 konsumatorë.

Konstatohet se, pagat në sektor shprehin pjesëmarrje me përqindje të lartë në shpenzimet operative të kompanive, me 59.82%. Po ashtu, analiza thekson shpërputhjen e rezultateve për të punësuar.

Inkurajohet kompanitë që të ndërmarrin veprimet adekuate për ta përmirësuar gjendjen.

Përveç KRU “Prishtina” dhe “Gjakova” KRU-të tjera nuk i kanë përmbushur caqet të investimeve kapitale. Kjo kërkon mobilitet të kompanive për t’i ulur shpenzimet dhe për t’i ulur humbjet e ujit, në mënyrë që nga këta dy zëra, t’i rrisin investimet kapitale nga burimet e veta financiare, duke përformuar më mirë dhe duke ngritur qëndrueshmërinë financiare të kompanive.

Analiza jonë lë për të dëshiruar, në besueshmërinë e të dhënave. Kemi hasur në metodologjinë e gabuar të evidencave kontabël, gjë që zbehin, jo vetëm besueshmërinë, por edhe pasqyrën reale të sektorit dhe të kompanive individuale. Sa për kuriozitet, vetëm një ilustrim. Kompania kredimarrëse, në pasqyrat financiare, nuk regjistron investimet në vijim, proporcionalisht me situacionet e përkohshme të pranuar, sipas periudhave kohore, por kompania kur bënë pranimin teknik të investimit kapital, e regjistron asetin në kontabilitet, si investim i njëhershëm përmbledhës. Jo vetëm kaq, kompania e kapitalizon edhe interesin bankar.

Dokumenti Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullator të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe Ujëra të zeza, përcakton kërkesat e ZRRUM për informata fillestare për të plotësuar detyrimet e përcaktimit të tarifave duke u bazuar në Procedurat Tarifore për Furnizim me Ujë dhe Ujëra të Zeza.

Këto udhëzime bazohen në nevojat për informacione të rregullatorit për qëllime të vendosjes së tarifave dhe në bazë të praktikës së mirë rregullatore, të adoptuar në shumë vende të botës, por të adaptuara për të plotësuar rrethanat specifike dhe mjedisin veprues brenda Kosovës. Në disa fusha këto udhëzime dhe kërkesa për raportim përfshijnë përkufizime dhe procese të evidentuara në udhëzime dhe procedura të agjencive tjera rregullatore të njohura, posaçërisht Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit (ofwat).

Kompanitë nuk duhet që t'i ngatërrojnë shpenzimet tjera direkte, siç është interesi bankar, për të tentuar që të përlllogaritet në urdhëresën tarifore, sepse në Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullator (versioni 2, qershor 2011) në zërin 4.7, alinea 9 saktëson: “Në shpenzimet tjera direkte hyn çfarëdo shpenzimi tjetër operativ, i ndërlidhur me secilin prej aktiviteteve , **por duke përfshijtur pagesat për kamata dhe taksa**”.

Auditimi i pasqyrave financiare të KRU-ve, në disa kompani ka gjetur mospërputhje në pasqyrat financiare të kompanive.

Të dhënat operative

Bazuar në metodologjinë e shkallës së vlerësimit të përmbushjeve të caqeve për këto të dhëna dhe të dhënat tjera, konkludohet se të dhënat operative për këtë grup të treguesve, rezultojnë tejkallim të caktuar të sasisë së ujit të prodhuar, gjatë periudhës së referuar që është një tregues pozitiv. Ndërkaq, numri konsumatorëve është përafëruar me planifikimin. Humbjet e ujit në m³ dhe sasia e ujit të faturuar në m³ nuk i kanë realizuar objektivat e përcaktuara të gjashtëmujorit të parë të vitit 2018.

Prodhimi i ujit ka tejkalluar sasinë e prodhimit të aprovuar nga ARRU, për 6,193,438 m³, ose 8.88% tejkallim i planifikimit. Po kështu sektori ka shënuar rritje prodhimi në raport me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, për 617,850 m³, ose 0.82% tejkallim planit të aprovuar për periudhën raportuese.

Në këtë gjashtëmujor, sektori ka shënuar një rritje jo të ndjeshme të gjithsej faturimit për ujë dhe ujëra të zeza, për vetëm 0.44 %, në raport me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Ndërsa, ka shënuar ngecje në realizimin e caktuar si sektor në faturim për 8.5%. Kjo është brengosje për ARRU, e cila inkurajon kompanitë që të ndërmarrin veprime konkrete për ta ndryshuar gjendjen.

Rekomandojmë që ofruesit e shërbimeve të bëjnë plane veprimi për rritjen e faturimit, për humbjet e ujit dhe adresimin e humbjeve.

Shpenzimet operative

Shpenzimet operative nevojiten që të ofrohen nga aktivitetet themelore dhe zërat e shpenzimeve kryesore

ARRU po angazhohet për një analizë të shpenzimeve operative për një mori qëllimesh duke përfshirë:

- përcaktimin e tarifave të nevojshme për aktivitetet e furnizimit me ujë dhe ujëra të zeza për secilën kompani;
- Monitorimin e performancës kundrejt projekteve të bëra në kohën kur janë përcaktuar tarifat;
- Vlerësimin e performancës kundrejt projekteve të bëra në kohën kur janë përcaktuar tarifat;
- Vlerësimin e performancës krahasuese në mes të kompanive për aktivitetet kryesore të lidhura me ofrimin e furnizimit të ujit dhe të shërbimeve të ujërave të zeza; dhe
- Monitorimin e gjendjes financiare të kompanive rajonale të ujit dhe aftësinë e tyre për të vazhduar financimin e shërbimeve të cilat ato i ofrojnë.
- Kompanitë duhet të identifikojnë të gjitha shpenzimet e përgjithshme dhe aktivitetet mbështetëse përbrenda aktivitetit të veçantë.

Udhëzimi i kontabilitetit Rregullator definon shpenzimet operative:

Shpenzimet direkte operative lidhur me ofrimin e shërbimeve që përfshijnë: fuçinë punëtore; energjinë; kemikaljet; materiet konsumuese; shpenzimet e përbashkëta; taksat e pa-
rimbursueshme dhe shpenzimet tjera.

Aktivitetet e Furnizimit me ujë, bëjnë pjesë:

- Resurset dhe trajtimi i ujit;
- Distribuimi i ujit të trajtuar

Aktivitete e shërbimeve-Ujërat e Zeza:

- Grumbullimi i Ujërave të zeza
- Trajtimi i Ujërave të Zeza
- Trajtimi dhe derdhja e llumit

Zërat e shpenzimeve direkte brenda aktiviteteve të shërbimit:

- Ngarkesat për shërbime;
- Shpenzimet e energjisë;
- Shpenzimet e derivateve;
- Shpenzimet e pagave;
- Materialet dhe materiet e konsumueshme;
- Shërbimet e kontraktuara;
- Shpenzimet e mirëmbajtjes;
- Shpenzimet tjera direkte(përfshihen pagesat për kamatë dhe taksa

Shpenzimet indirekte-Aktivitetet biznesore(të përbashkëta):

- Shërbimet e konsumatorëve;
- Shërbimet shkencore;
- Shpenzimet e rregullatorit;
- Aktivitetet e përgjithshme dhe mbështetëse

Brengë e analizës sonë është se disa kompani kanë praktikuar evidenca kontabël me nivel jo të kënaqshëm të besueshmërisë, duke mos i evidentuar interesin bankar si shpenzim jo operativ, por atë e kanë kapitalizuar si vlerë e investuar e aseteve, sikundër gabimeve tjera tek regjistrimi i investimeve në vlera të tërësishme financiare, vetëm në momentin e pranimit teknik të investimit dhe jo duke i regjistruar ato sipas situacioneve të përkohshme, si investime në vijim, duke siguruar evidencë kontabile të azhurnuar.

Shpenzimet operative duhet të demonstrojnë fotografinë reale të tyre në evidencat kontabël të kompanive dhe vetëm si të tilla duhet t'i prezantohen rregullatorit.

Nga totali i shpenzimeve operative që kanë ndodhur për gjashtëmujorin e parë të vitit 2018, 92.78% të shpenzimeve u shënuan në shërbimin e ujit, ndërsa 7.22 % janë shpenzime të ujërave të ndotura.

Është tejet pozitive fakti që sektori ka arritur që të ketë më pak shpenzime operative sesa planifikimi, dhe atë për 1,398,301 €, ose 10.57% më pak se planifikimi. Inkurajojmë KRU-të që edhe më tej t'i ulin shpenzimet operative për njësi. Kështu që sektori ka arritur që të ketë një tejkallim pozitiv të caktuar.

Brengosëse është KRU Mitrovica, e cila është e vetmja kompani që nuk ka arritur cakun, madje për 25.16 %.

Inkurajojmë KRU-të që të përpiqen që t'i ulin shpenzimet operative edhe më tej, sepse kjo ndikon në qëndrueshmërinë financiare të kompanisë si dhe krijohen mundësitë për përtëritjen e aseteve nëntokësore.

Konstatojmë se, pagat në sektor shprehin pjesëmarrje me përqindje të lartë në shpenzimet operative të kompanive, me 59.82%. Po ashtu, analiza thekson mospërputhjen e rezultateve për njësi, në raport me pagat.

Sektori bënë punësime jo adekuate me profilin që ka nevojë më së shumti. Vërehet mungesë e konsiderueshme e hidroinxhinierëve, ndërkaq punësohen profile tjera.

Ndër KRU-të që ka shpenzimet më të vogla të energjisë elektrike për sasinë e ujit që ekstraktin është KRU "Gjakova", kurse si kompani që ka shpenzimet më të madhe të energjisë elektrike janë "Hidroregjioni-Jugor" (25.23%) dhe KRU "Prishtina" (23.87%), kjo si ndikim i konfiguracionit të terrenit, e cila imponon aktivizimin e pompave për shtyrje të ujit deri tek konsumatori. Analiza e këtyre shpenzimeve, shpie në nevojën e avancimit të pajisjeve, dhe metodologjisë, e cila mundëson shpenzime më të ulëta të rrymës për njësinë e prodhimit dhe shpërndarjes. Praktika e vendeve tjera ofron mundësinë e shfrytëzimit më efektiv të energjisë elektrike. Disa kompani kanë pasur edhe asistencë, nga donatorët, kurse praktikantët e tilla nuk i kanë aplikuar me sukses, gjë që është brengosëse. Inkurajojmë kompanitë që të bëjnë përpjekje për t'i zvogëluar këto shpenzime, duke absorbuar praktika më të mira dhe më eficiente.

Faturimi

Në këtë gjashtëmujor, sektori ka shënuar një rritje jo të ndjeshme të faturimit në kumulativ për ujë dhe ujëra të zeza, për vetëm 0.1 %, në raport me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Ndërsa, ka shënuar ngecje në realizimin e caktuar si sektor në faturim për 8.69 %. Kjo diskrepancë shpie në brengosje serioze.

Ndërkaq, sektori ka dështuar në arritjen e caktuar për faturimin e ujit për 1,623,047 €, ose dështim të caktuar për 9.2%, gjë që është brengosëse. Për Ujëra të ndotura sektori ka shënuar rritje në raport me të njëjtën periudhë të vitit paraprak prej 134,827.00 €, kurse ka ngecje në raport me planin e aprovuar në vlerë financiare prej 100,881.00€. Sektori ka arritur që të përafrohet me realizimin e caktuar.

Në tërësi, sektori së bashku ujë dhe ujëra të ndotura ka tejkaluar vitin paraprak për 15,961 €, ose tejkalim për 0.1%, kurse ka ngecje në realizimin e caktuar për 1,589,566 € ose mosrealizim të caktuar prej 8.69%, që është brengosëse dhe inkurajojmë KRU-të që të ndër marrin veprimet e duhura për realizimin e caktuar deri në fund të vitit.

Ky indikator është thelbësor për funksionimin dhe qëndrueshmërinë financiare të kompanive rajonale. Faturimi është çelës i suksesit të kompanisë, matës i zgjerimit të zonës së shërbimit dhe gjithë përfshirjes. Ky indikator ka impakt të drejtpërdrejtë në të ardhurat e veprimtarisë së kompanisë, në investimet kapitale, në mirëmbajtje, zgjerimin e burimeve të furnizimit me ujë, në përmirësimin e standardeve, cilësisë dhe në progresin tekniko teknologjik të sektorit.

Kjo, përbën njërin nga shqetësimet më serioze për Autoritetin Rregullator të Shërbimeve të Ujit.

ARRU rekomandon kompanitë- ofruese të shërbimeve që ta rrisin bazën e shtrirjes së konsumatorëve.

Arkëtimi

Të ardhurat duhet të paraqiten si shuma e pritur (duke përfshirë TVSH) nga konsumatorët sa i përket furnizimit të ujit dhe shërbimeve të ujërave të zeza të ofruara gjatë periudhës. Shumat e pritura sa i përket ujit dhe ujërave të zeza duhet të paraqiten ndaras. Të ardhurat e pranuar për

aktivitetet tjera (të ardhurat nga furnizimet me shumicë të ujit të palëve të treta) duhet të paraqiten si të ardhura jo-themelore.

Në nivel të sektorit shuma e planifikuar e arkëtimit është realizuar 91.10 %, duke manifestuar nivel jo të kënaqshëm të arkëtimit.

Mos realizim i caktuar të arkëtimit, vjen si ndikim i mungesës së realizimit të faturimit në m³ dhe faturimit në vlerë financiare. Megjithatë, kjo vlerë e realizuar e arkëtimit nuk praqet vlerën reale për arkëtimet e vitit fiskal të gjashtëmujorit të parë të viti 2018, sepse në të janë të përfshira edhe arkëtimet e viteve paraprake. Prandaj shumat e arkëtuara nga planifikimi i arkëtimeve nga veprimtaria për gjashtëmujorin e vitit 2018, nuk paraqesin gjendjen reale të arkëtimit nga faturimi në vitin fiskal të periudhës, por aty përfshihen edhe inkasimet e periudhave të kaluara.

Kur nga shuma e prodhimit, zbritet faturimi dhe arkëtimi, atëherë përfitojmë një diskrepancë të konsiderueshme, e cila është brengosëse.

Përkundër vështirësive që kanë kompanitë në arkëtimin e faturave të lëshuara konsumatorëve, gjithsesi që ka mangësi në menaxhimin e këtij indikator, aq të rëndësishëm, duke mos shterur të tëra mundësitë e mundshme, përfshirë edhe fushatën informuese dhe ndërgjegjësuere të konsumatorëve shtëpiak, komercialë dhe atyre institucionale.

ARRU rekomandon ofruesëve të shërbimeve ndërmarrjen e masave shtesë për të ngritur zgjerimin e konsumatorëve dhe ngritjen e arkëtimit për njësi.

Investimet Kapitale

Investimet kapitale nga burimet e vetëfinancimit të kompanive të sektorit, mbesin ndër pikat më të dobëta të caqeve për t'u realizuar.

Në bazë të ktyre të dhënave KRU Prishtina ka tejkaluar cakun edhe për ujëra të ndotura po ashtu edhe KRU "Gjakova" ka arritur të përmbush dhe tejkalojë cakun e planifikuar prej burimeve vetanake.

Përveç KRU "Prishtina" dhe KRU "Gjakova" që kanë arritur të përmbushin cakun, KRU-të tjera nuk kanë arritur ta realizojnë atë. Kjo mungesë e realizimit, vjen si rrjedhojë e një ndërvarësie të afarizmit të kompanive, që ndërlidhet me mungesën e realizimit të faturimit në m³ dhe në €, rrjedhimisht edhe me mungesën e realizimit në arkëtim.

Realizmi i investimeve kapitale nga burimet vetjake të financimit, është indikatori që më së miri shpreh gjendjen financiare të kompanisë dhe qëndrueshmërinë e saj financiare.

Rekomandojmë kompanitë që të shmangin metodologjinë e gabuar të evidencave kontabël, dhe i inkurajojmë ato që ta zbatojnë legjislacionin në fuçi të Ligjeve të ATK-së

si dhe kontabilitetin rregullator, në të kundërtën, kompanitë do të rrëshqasin në pasqyrat financiare që nuk reflektojnë fotografinë e gjendjes reale të tyre.

Inkurajojmë kompanitë rajonale që t'i korrigjojnë regjistrat e aktiveve afatgjata materiale, duke kapitalizuar vetëm vlerën e kryegjësë të kredive që këstet e anuitetit do të paguhet nga burimet vetjake të financimit, kurse të hiqen vlerat e interesit të paguar, dhe kjo vlerë të mbahet tek shpenzimet jo operative, duke ulur bazën tatimore të kompanisë.

Inkurajojmë kompanitë rajonale që të shmangin gabimet në evidencat e tyre kontabël dhe ta rrisin besueshmërinë e të dhënave për shfrytëzuesit e tyre dhe palët e treta.

Gjithashtu, rekomandojmë kompanitë rajonale që ta realizojnë me përpikëri planin rregullator për investimet kapitale, sepse ato plane janë përfshirë edhe në përlllogaritjen e tarifës së shërbimit dhe se konsumatorët i kanë paguar këto investime të planifikuara përmes tarifës së shërbimit.

ARRU, mosrealizimin e planit rregullator të investimeve kapitale nga burimet e vetëfinancimit të kompanive, do ta kompensojë, përmes procesit të ardhshëm tarifor, duke zbritur tarifën e shërbimit në ekuivalencë me nivelin e ngecur të investimeve të tilla, për të cilat KRU-të kanë inkasuar para pa mbulesë (në dëm të konsumatorëve). Dhe kështu, përmes zbritjes së tarifës së shërbimit, konsumatorëve iu kthehen paratë e marra më tepër.

Rekomandojmë kompanitë rajonale, ofruese të shërbimeve për ujë dhe ujëra të zeza, që të bëjnë plane veprimesh për implementimin e rekomandimeve të ARRU.